L I G J
Nr. 8969, datë 7.11.2002

PËR DISA MASA NË FUSHËN E TRANSMETIMEVE RADIOTELEVIZIVE

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Për sigurimin e parametrave teknikë për identifikimet dhe matjet në terren, të domosdoshme për bërjen e Hartës së Frekuencave për Transmetimet Radio e Televizive, merren këto masa:

1. Ndërpritet procesi i konkurrimit dhe dhënia e licencave të reja për transmetime radiotelevizive nga KKRT-ja deri në daljen e Planit të Frekuencave për Transmetime Radio e Televizive.

2. Ndërpritet zgjerimi i mëtejshëm i mbulimit me sinjal dhe ndryshimi i parametrave teknikë të impianteve ose zhvendosja e tyre, të paautorizuara nga operatorët radiotelevizivë të licencuar.

3. Të gjithë operatorët radiotelevizivë që transmetojnë përtej zonave të transmetimit të lejuara me licencë, për periudhën kohore të përcaktuar në këtë ligj, ruajnë gjendjen aktuale të impianteve të instaluara.

4. Për identifikimin e sinjaleve radiotelevizive që vijnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, mbështetur në një plan veprimi të detajuar, të miratuar nga KKRT-ja, për orë të caktuara ndërpritet transmetimi radioteleviziv i subjekteve që operojnë në zonën ku kryhen matjet.

Neni 2

Të gjitha subjektet që ritransmetojnë programe radiotelevizive të huaja me përsëritës, pa pasur licencë për këtë qëllim, në kundërshtim me nenet 128 deri 135 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", të ndërpresin menjëherë këtë ritransmetim.

Neni 3

Shkelja e pikës 2 të nenit 1 dhe e nenit 2 ndëshkohet me bllokimin e pajisjeve dhe heqjen e licencës sipas procedurave të parashikuara nga neni 137 pikat 2 dhe 3 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë".

Subjektet që veprojnë në kundërshtim me pikën 4 të nenit 1 dënohen nga KKRT-ja me gjobë nga 60 000 deri 1 000 000 lekë.

Kundër masave të mësipërme subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 4

Ky ligj i shtrin efektet e tij ligjore për një periudhë kohore prej 5 muajsh nga data e hyrjes në fuqi.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3586, datë 4.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu